Wilson Center Digital Archive
International History Declassified
digitalarchive.wilsoncenter.org

# June 23, 1961

# Telegram from Gaqo Paze, the Albanian Ambassador in GDR to the Ministry of Foreign Affairs of Albania

## Citation:

"Telegram from Gaqo Paze, the Albanian Ambassador in GDR to the Ministry of Foreign Affairs of Albania", June 23, 1961, Wilson Center Digital Archive, AMPJSh V. 1961 D. 422, p. 28 https://wilson-center-digital-archive.dvincitest.com/document/110163

## Summary:

Gaqo Paze reports from Berlin that during the conversation between the Yugoslav Ambassador to Berlin Voshnjak, and the Soviet ambassador to Berlin Pervukhin, the latter had asked if Yugoslavia would subscribe to the peace treaty with the GDR if the Western states would not accept to sign the peace treaty with both German states. Voshnjak avoided giving a direct answer several times, but in the end he implicitly expressed, according to Gaqo Paze, that Yugoslavia would not sign the treaty.

## Original Language:

Albanian

## Contents:

- Original Scan

Wilson Center Digital Archive Original Scan

I DEKLASIFIKUAR

TEPËR SEKRET
Nr. Fletës 52

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja Nr
Fleta:

# DESHIFRIM

Nr. 339I Nga BERLINI Nr 019889

| PËR SHËNIME | PËRMBAJTJA |
|---|---|
| Mora njoftim<br>data<br>ora<br>Firma | r. 235 Data 23/6/961 |

MINISTRISE JASHTËME

Në pritjen e dhënë më 22 Qershor nga ambasadori Hungarez për nder të delegacionit parlamentar Hungarez, Pervukini pati një bisedim me ministrin Jugosllav Voshnjak për këto probleme: I) Pervukini duke qeshur pyeti ministrin Jugosllav si shkojnë punët për pregatitjen e bllokut të tretë. Ministri Jugosllav ju përgjegj se këtu nuk bisedohet për bllok pse qëllimi ynë është për ruajtjen e paqes. Ambasadori Rumun duke ju drejtuar Jugosllavit i tha: Ju nuk doni tu thuhet se bëni pjesë në pakte. Jugosllavi u mundua të tregojë se qëllimi i krijimit të organizatës së shteteve neutrale është për ruajtjen e paqes. Vijon

| U-muar në dorëzim | | Kur filloj deshifrimi | | Kur mbaroj deshifrimi | | Firma e Shifrantit | Firma e kontrolluesit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| data | ora | data | ora | data | ora | | |
| 23/6/61 | 16 | 24/6/61 | 9.00 | 24/6/61 | 9.30 | V.C. | |

Të rikthehet në organin e shifrës jo më vonë se 5 minuta
Ndalohet me nxjerrë kopje

TEPËR SEKRET
Nr. Fletës 53

# DESHIFRIM

Nr. 3392 Nga Nr 019891

| PËR SHËNIME | PËRMBAJTJA |
|---|---|
| Mora njoftim<br>data<br>ora<br>Firma | r. 236 Data |

PJESA E DYTË TELIT Nr.235

Pervukini pyeti ministrin Jugosllav në se Jugosllavija do të nënshkruaj traktatin e paqes me R.D.Gj. në rast se fuqitë perëndimore nuk do të pranojnë që traktati i paqes të nënshkruhet me dy shtetet Gjermane. Jugosllavi u mundua në fillim mos përgjigjet direkt. Ai ngriti çështjen se qeverija Jugosllave përkrah memorandiumin sovjetik për çështjen Gjermane si domos për atë pjesë ku bëhet fjalë për domosdoshmërinë e zhvillimit të bisedimeve midis përfaqësuesve të lindjes e perëndimit. Pervukini i tha se ne jemi për bisedime pune dhe se brënda këtij viti ne do ta nënshkruajmë pa tjetër traktatin e paqes. Minstri Jugosllav tha se duhet pritur rezultati bisedimeve pastaj të vendoset. Vijon

| U-muar në dorëzim | | Kur filloj deshifrimi | | Kur mbaroj deshifrimi | | Firma e Shifrantit | Firma e kontrolluesit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| data | ora | data | ora | data | ora | | |
| 23/6/61 | 16 | 24/6/61 | 9.30 | 24/6/61 | 9.50 | V.C. | |

Wilson Center Digital Archive Original Scan

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja: Fleta:

30

I DEKLASIFIKUAR

Të rikthehet në organin e shifrës jo më vonë se 5 minuta
Ndalohet me nxjerrë kopje

TEPËR SEKRET
Nr. Fletës 24

# DESHIFRIM

Nr. 3393 Nga BERLINI № 019893

PËR SHËNIME | PËRMBAJTJA

Mora njoftim
data
ora
Firma

r. 237 Data

**PJESA E TRETE E TELIT Nr.235**

Pervukini i rezoi kete thenie duke i thene ~~ne bisedime~~ nuk bejme, ne do te bejme bisedime vetem ~~xxxxx~~ ne ~~xxxxxx~~ perendimoret do te pranojne te nenshkruajne traktatin e paqes brenda ketij viti. Pas kerkeses per te treten here nga ana e Pervukinit Ministri jugosllav tha se: ai nuk mund te thoshte asgje ne se do ta firmoste jugosllavia traktatin e paqes apo jo. La te nenkuptohet se jo. Ministri jugosllav gjithashtu tha ai nuk e shikonte drejt qe ne deklaraten e partive politike te R.D.GJ., keshillit te shtetit dhe te keshillit te Ministrave date 15 qershor u behet thirje per veç fuqive te medha edhe polonise, cekosllovakise per organizimin e konferences se paqes dhe jugosllavija jo. Pervukini i holli poshte dhe kete duke i thene qe nuk

Vijon.

| U-muar në dorëzim | | Kur filloj deshifrimi | | Kur mbaroj deshifrimi | | Firma e Shifrantit | Firma e kontrolluesit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| data | ora | data | ora | data | ora | | |
| 24/6/61 | 16 | 24.VI | 10 | 24.VI | 10.40 | A.TH. | |

31

Të rikthehet në organin e shifrës jo më vonë se 5 minuta
Ndalohet me nxjerrë kopje

TEPËR SEKRET
Nr. Fletës 25

# DESHIFRIM

Nr. 3394 Nga BERLINI № 019885

PËR SHËNIME | PËRMBAJTJA

Mora njoftim
data
ora
Firma

r. 238 Data

**PJESA E FUNDIT E TELIT Nr.234**

duhet kapur nga kjo gje qe nuk eshte principale dhe se Pollonia dhe Çekosllovakia jane te interesuar per regullimin e problemit gjerman dhe se kane qene viktimat e para te agresionit gjerman. Per thirjen e konferences duhen disa inisjatore. Pervukini i tha pastaj qe ne rast se kerkoni te gjini inisjatoret te konferences at-here kete te drejte e kane edhe shqiptaret bullgaret, rumunet etj. Jugosllavi i tha jo te gjithe vendet nje soj. Pervukini ju pergjegj: te gjitha popujt kane dhene kontributin e tyre ne lufte kundra fashizmit. Biseda u nderpre me qene se u largua Pervukini.

GAQO

| U-muar në dorëzim | Kur filloj deshifrimi | Kur mbaroj deshifrimi | Firma e Shifrantit | Firma e kontrolluesit |
|---|---|---|---|---|